



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
SEKTORI PËR TË DHËNAT E HAPURA DHE KONSULTIMIN PUBLIK

Nr. 869/1 prot.

Tiranë më 05.04.2024

Lënda: Jepet mendim për një projektvendim

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 28/2 Prot., datë 26.03.2024 me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin *“Për përcaktimin e të dhënave me vlerë të madhe të lëvizshmërisë dhe masat për publikimin e tyre me qëllim ripërdorimi”*, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, *“Zyra e Komisionerit”*) referuar ligjit nr. 33/2022 *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”*, Direktivës së (BE) 2019/1024 me po të njëjtin titull, si dhe Rregullores Zbatuese të Komisionit Evropian 2023/138/BE, të datës 21 dhjetor 2022, e cila synon të përafrohet me këtë akt, shprehet parimisht dakord me projektvendimin, duke paraqitur komentet si më poshtë:

- Në pjesën hyrëse të projektvendimit të shtohet si bazë ligjore edhe neni 17 i ligjit nr. 33/2022 *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”*.
- Kudo në këtë projektakt, togfjalëshi *“... të lëvizshmërisë...”* të zëvendësohet me *“... të lëvizshmërisë dhe transportit publik”*.
- Kudo në këtë projektakt, togfjalëshi *“...i të dhënave me vlerë të madhe ...”* të zëvendësohet me *“...i grupeve specifike të të dhënave me vlerë të madhe...”*.
- Në pikën 7 të nenit 4, togfjalëshi *“...që mbajnë grupe të dhënash me vlerë të madhe ...”*, të zëvendësohet me *“...që mbajnë grupe të dhënash me vlerë të madhe sipas këtij vendimi...”*.
- Emërtesa e nenit 5, të bëhet *“Ripërdorimi për kategorinë e grupeve të të dhënave me vlerë të madhe të lëvizshmërisë dhe transportit publik”*.
- Pika 1 e nenit 5, të riformulohet si vijon: *“Çdo përjashtim në përputhje me nenin 17 pika 4 të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, publikohet online në faqen e internetit të institucionit përkatës, duke patur parasysh parashikimet në nenin 10 pika 3 të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik””*.

- Në pikën 2 të nenit 5, togfjalëshi “...kësaj rregulloreje” të zëvendësohet me “...këtij vendimi”.
- Në nenin 5, kudo togfjalëshi “...me vlerë të lartë...” të zëvendësohet me “...me vlerë të madhe”.
- Emërtesa e nenit 6, të bëhet “Rregullat për publikimin e grupeve të të dhënave me vlerë të madhe të lëvizshmërisë dhe transportit publik”.
- Në nenin 6, kudo togfjalëshi “Publikimi i të dhënave...” të zëvendësohet me “Publikimi i grupeve të të dhënave...”.
- Pika 1 e nenit 7, të bëhet: “Organet e sektorit publik që mbajnë të dhënat sipas përcaktimeve në nenin 3 të këtij vendimi, raportojnë tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Aty ku është e përshtatshme, informacioni mund të sigurohet nëpërmjet referencave në metadatat përkatëse”.
- Pika 2 e nenit 7, sugjerojmë të hiqet.
- Gërma b), e pikës 3 të nenit 7, të bëhet: “lidhje e vazhdueshme me kushtet e licencimit të zbatueshme për ripërdorimin e grupeve të të dhënave me vlerë të madhe të listuara në nenin 3 të këtij vendimi , për bazën e të dhënave, të përmendur në pikën a)”.
- Gërma f), e pikës 3 të nenit 7, të saktësohet si vijon: “listën e organeve të sektorit publik të përjashtuar në përputhje me nenin 17 pika 4, të ligjit 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi